

D E K R E T
Nr.686, datë 9.11.1993

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DISA MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 28, pika 7, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zoti Genc Ruli lirohet nga detyra e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, sipas kërkesës së tij dhe ngarkohet me detyrë tjetër.

Neni 2

Zoti Artan Hoxha lirdohet nga detyra e ministrit të Tregëtisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, pasi do të caktohet në një detyrë tjetër.

Neni 3

Zoti Abdyl Xhaja lirohet nga detyra e ministrit të Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe emërohet Ministër i Energjetikës dhe Burimeve Minerare.

Neni 4

Zoti Piro Dishnica emërohet ministër i Financave.

Neni 5

Zoti Selim Belortoja emërohet ministër i Industrisë dhe Tregtisë.

Neni 6

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar nga Kuvendi Popullor me ligjin nr.7774, datë 23.11.1993.